

Data 28.09.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për sigurimin e jetës të punonjësve të MZSH_së” per vitin 2023.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 66511000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.159.896 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektivit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçense profesionale të lëshuar nga Autoriteti Mbikqyrës Financiar për kryerjen e aktivitetit në fushën e Sigurimeve ku përfshihet dhe Sigurimi i Jetës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si edhe në mbështetje të ligjit Nr 9572 dt 03.07.2006 për "Autoritetin e Mbikqyrjes financiare" (i ndryshuar). Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës pra me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kjo licensë garanton Autoritetin Kontraktor se ofertuesit e mundshëm ekonomikë janë të licensuar për realizimin e këtij lloj shërbimi dhe në këtë mënyrë të krijohet bindja tek Autoriteti Kontraktor se kontrata do të realizohet me sukses.

2.1.3 Licenca profesionale dhe CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës:

Shoqëria e sigurimit duhet të ketë pjesë të stafit të tij minimalisht 1 (një) vlerësues dëmsh në sigurime të liçencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas parashikimit të kuadrit ligjor në fuqi. Për të vërtetuar këtë kriter Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

CV (curriculum Vitae)

Kontratë pune (e vlefshme)

Licencë e vlerësuesit të dëmit në sigurime (e vlefshme)".

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Përsa i përket vlerësuesit të dëmeve sqarojmë si më poshtë vijon:

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime është personi i licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për vlerësimin e dëmeve të ndodhura si pasojë e një ngjarje sigurimi.

Procesi i vlerësimit përfshin mbledhjen e të dhënave dhe përlogaritjen e shumës që duhet të paguhet nga shoqëria e sigurimit për dëmet, si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Vlerësuesit e dëmeve, bazuar në treguesit dhe koeficientët e përcaktuar nga Institucionet kompetente për përcaktimin e shkallës së dëmtimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, përcaktojnë në mënyrë profesionale dhe të paanshme shumën e dëmshpërblimit që shoqëria e sigurimit detyrohet të paguajë ndaj personave të sigurve, për dëmet si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, deri në limitin e përgjegjësisë të përcaktuar sipas kontratës së sigurimit.

Parimi bazë është se Vlerësuesi i dëmeve kryen vlerësimin në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$4.159.896 \times 40\% = 1.663.958,4 \text{ lekë}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin*

nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik do të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikime teknike:

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet.

1.Drejtoria e MZSH-së – Bashkia Tiranë, është e organizuar në struktura inspektuese dhe operuese të gatishmërisë së përhershme. Kjo drejtori në përputhje me detyimet ligjore në fuqi, përgjigjet për drejtimin e shërbimit zjarfikës në territorin e Bashkisë Tiranë.

2.Sipas kërkesave të parashikuara në **nenin 32** të **ligjit Nr.152/2015**, të miratuar me datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, përcaktohet se: *Punonjësi i shërbimit të MZSH-së përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.*

- Sipas kërkesave të **VKM Nr. 382, date 13.05.2020** “Për sigurimin e jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, njësitë e qeverisjes vendore kanë detyrimin, që të sigurojnë jetën e punonjësve të Shërbimit të MZSH-se nga aksidentet gjatë kryerjes së shërbimit ose për shkak të tij.

- Ne piken 4 te VKM Nr.382/2020 “Për sigurimin e jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, percaktohet se: *Kontrata e sigurimit të jetës nga aksidentet të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin mbulon ngjarjet aksidentale*, si më poshtë vijon:
 - a. Vdekje si rezultat i aksidentit;
 - b. Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti gjatë shërbimit ose për shkak të tij;
 - c. Paaftësi e përhershme gjatë shërbimit ose aftësi e kufizuar gjatë shërbimit, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
 - d. Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
 - e. Paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

Shërbimet spitalore dhe/ose mjekësore në spitalet publike ose bazuar në marrëveshjen me shtetet e tjera për mbulimet shëndetësore që nuk ofrohen në spitalet publike të vendit.3Punonjësit, të cilët përfitojnë sigurim jete, janë vetëm punonjësit që kryejnë funksione operacionale, ku sipas te dhenave te Drejtorise se Sherbimit te MZSH-se, kete sherbim e perfitojne **156** punonjës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Staf i MZSH-së, do të kompletohet me policat e sigurimit nga Operatori Ekonomik fitues brenda 10 (ditëve), pas lidhjes së kontratës me Autoritetin Kontraktor.

Periudha e sigurimit është një vit nga data e policës së sigurimit.

Autoriteti Kontraktor do të pajisë Operatorin ekonomik me listën e 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) punonjësve të MZSH-së pas shpalljes fitues i kontratës.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Shpenzime për sigurimin e jetës të punonjësve të MZSH-së**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- Dokumentat e tenderit.

Njësia e prokurimit